



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 68/2012
Prishtinë, më 26.06.2012, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Berat Buzhala, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq.

Mungoi: Teuta Sahatqija dhe Ramiz Kelmendi.

Pjesëmarrës i ftuar: Fehmi Mujota, ministër i Ministrisë së Infrastrukturës.

Pjesëmarrës të tjerë: Lah Nitaj, Xhemë Berisha, Ali Aliu, Avdi Kameroli dhe Jakup Hoti- MI; Dritan Gjonbalaj-AAC; Enis Berisha- ARH; Gani Koci, zëvendësministër i MZHE, Arbnor Kastrati, Besim Veselaj, Dukagjin Shala dhe Kemail Zeqiri - MZHE; Ukë Gashi - ZPRK; Dita Dobranja – INDEP, Haxhi dhe Florije Mehmeti – KDI.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.06.2012;
3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit 2011;
4. Shqyrtimi i Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025;
5. Te ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me tetë (8) vota Për dhe një (1) Kundër.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.05.2012

Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 28.05.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit 2011

Zenun Pajaziti, kryetari i Komisionit – Tha se sa i përket kësaj pikë z. Fehmi Mujota, ministër në Ministrinë e Infrastrukturës i ka sjellë më shkrim përgjigjet, lidhur me përmbushjen e sfidave të dala nga Raporti i Progresit për vitin 2011 dhe ia kaloi fjalën për prezantim të raportit.

Fehmi Mujota, ministri në Ministrinë e Infrastrukturës- I njoftoi deputetët për hapat e deritashëm që ka marrë ministria për përmbushjen e detyrimeve të dala nga Raporti i Progresit, për të cilat tha se ato janë arritur në masën më të madhe dhe është duke u punuar në përmbushjen e tyre në tërësi. Ministri Mujota, në mënyrë kronologjike paraqiti hapat që i ka marrë Ministria, duke filluar me Planin e Veprimit (lidhur me themelimin e veçantë të Departamentit për Shërbime Postare brenda Autoritetit Rregullator për Telekomunikacion), për strategjinë e digjitalizimit dhe anëtarësimin e Kosovës në Unionin Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU). Për Këshillin për siguri në rrugë, sinjalizimi horizontal dhe vertikal, si dhe për Divizionin e ri për politika të transportit në Ministrinë e Infrastrukturës, për ndarjen e slloteve, për funksionimin e Autoritetit Rregullator të Hekurudhave, për standardizimin e sistemit dhe vlerësimit të sigurisë për aeroplanët e huaj dhe lidhur me krijimin e Shërbimeve të navigacionit ajror, si dhe hetimit të aksidenteve. Ndër objektivat e tjera që Ministria synon të arrijë, ministri Mujota radhiti përmirësimin e infrastrukturës nëpër rrugët magjistrale dhe tha se kemi bërë projekte dhe analiza se si mirëmbahen këto magjistrale. Duke iu referuar pikës 167 të Raportit, me ç'rast nga ministria kërkohen masa për sigurimin e komunikacionit rrugor, ministri Mujota nënvizoi: "Në vitin 2011, numri i përgjithshëm i aksidenteve është rritur për 5%, i lëndimeve për 4% dhe i dëmeve materiale për 6.1%, ndërkaq numri i aksidenteve me pasoja fatale në vitin 2011 është më i vogël për 17.4%", krahasuar me vitin 2010". Në vijim, ministri foli për shthurjen operative dhe financiare të kompanive. Lidhur me këtë, ai njoftoi se ka përfunduar shthurja operative dhe financiare e kompanive "Infrakos" dhe "TrainKos", për të cilat tha se janë duke funksionuar të pavarura. Për sa i përket planifikimit të orareve të fluturimeve, sipas pikës 170 të Raportit, ministri njoftoi se nga 1 qershori i vitit të kaluar, ka hyrë në fuqi vendimi i ministrisë për kategorinë e koordinimit të aeroportit nga niveli tre në nivelin e dytë të koordinimit, dhe zyra për planifikim të orareve të fluturimeve ka aplikuar të gjitha parametrat e kërkuar. Po ashtu, ministri foli edhe për pikën e Raportit e cila bënë fjalë për standardizimin e sistemit dhe vlerësimit të sigurisë për aeroplanët e huaj. Lidhur me këtë, ministri Mujota njoftoi se Autoriteti i Kosovës për Aviacion Civil (AAC) nuk është pjesë e standardizimit të sistemit dhe vlerësimit të sigurisë për aeroplanët e huaj, si pasojë e mosmarrëveshjes lidhur me statusin e Kosovës.

Myzejene Selmani - Tha se sa i përket çështjes së Raportit të Progresit po shihet së jo të gjitha çështjet që janë ngritur, janë në kompetencat e MI-së, disa sfida dhe pyetje që kanë dalë nga Raporti i Progresit për vitin 2011, as që kanë të bëjnë me Ministrinë e Infrastrukturës, por ka pyetje që janë përmbushur sfidat. Mirëpo, ende janë duke u përsëritur nëpër Raportin e Progresit,

dhe në fund kërkoi që të informohet Komisioni Evropian për përmbushjen e këtyre pikave, që janë përmbushur nga ana e MI-së.

Lutfi Zharku – Pyeti për çështjen e ndarjes së tregut të kontrolleve teknike të automjeteve se si janë të rregulluar në treg ndarjet e këtyre pikave të kontrolleve? Për çështjen e rrugës Prishtinë-Hani i Elezit pyeti se a ka ndonjë plan dhe projekt për zgjerim të kësaj rruge magjistrale? Dhe për çështjen e rrethit të rrugës në Sllatinë për në aeroport, se a është zgjedhur çështja e shpronësimit?

Hashim Deshishku - Pyeti për çështjen e ndarjes së buxhetit për sinjalizimin e rrugëve se a ka ndarë buxhet Ministria e Infrastrukturës për vitin 2012? Për ARH- në po thuhet se nuk kanë staf të mjaftueshme, a është për çështje të buxhetit apo si qëndron puna? Lidhur me zgjerimin e rrugëve Prishtinë – Pejë dhe Prishtinë- Mitrovicë, pyeti se kur priten të përfundojnë këto projekte dhe ka ende problem të pazgjedhur të shpronësimit?

Biserka Kostiq- Pyeti për çështjen e tabelave treguese nëpër vendbanime, se sa po respektohet ligji për përdorimin e gjuhëve zyrtare? Dhe ngriti çështjen se aty ka tabela treguese nëpër vendbanime, ka rast që ka gabime gjuhësore dhe drejtshkrimore dhe ka vend që po fshihen emërtimit që janë të shënuara në gjuhën serbe.

Fehmi Mujota, ministër i Infrastrukturës – U përgjigj në pyetje të deputetëve si vijon: Për çështjen e pyetjeve të adresuara nga Komisioni Evropian, tha ata i adresojnë sfidat në Ministrinë e Infrastrukturës, pastaj ne i adresojmë nëpër departamente dhe agjencinë përkatëse të MI-së. Për çështjen e kontrolleve teknike, tha që më nënshkrimin e udhëzimit administrative që është nënshkruar, kjo çështje është rregulluar kështu që nuk ka as një kufizim në treg për kompanitë që dëshirojnë të aplikojnë. Kompanitë në këtë drejtim janë të rregulluar në aspektin ligjor, duke lejuar konkurrencën e tregut të lirë. Për çështjen e shpronësimit, tha që problemi qëndron se çdo lëndë për shpronësimi duhet të kalojë nëpër tri ministrit, si Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pastaj një tjerë problem që po paraqitet është vlera e vlerësimit që palët po janë të pakënaqura, dhe kjo po na merr shumë kohë, por ne kemi planifikuar që deri në nëntor të kiti viti të përfundojnë zgjerimi i rrugëve magjistrale në tërësi. Për çështjen e rrugëve magjistrale, tha ka plane dhe projekte për zgjerimin dhe rregullimin e tyre. Ministrinë e Infrastrukturës, në bazë të analizave dhe projekteve, ka planifikuar që në vitin 2013 të dedikohet buxhet më i madh për mirëmbajtjen e rrugëve magjistrale, përfshirë dhe rrugën Prishtinë – Hani Elezit. Dhe lidhur për respektin e përdorimit të gjuhëve zyrtare në tabletë treguese nëpër vendbanime, tha që kjo çështje në aspektin e vendosjes së tabelave më emërtim të vendbanimeve i takon MI-së, por mund të ketë dhe gabime gjuhësore dhe drejtshkrimore edhe në gjuhën shqipe, ndërsa sa i parkete fshirjes së mundshme të emërtimeve, tha se përgjegjëse është Ministra e Punëve të Brendshme dhe Policia për ruajtjen dhe mos dëmtimin e këtyre tableta më emërtime treguese të vendbanimeve.

Pas debatit të gjerë, Komisioni unanimisht nxori këtë

Konkluzion

Komisioni do të vazhdojë me agjendën për Integritet evropian duke përmbushur detyrimet që ka në Planin e Veprimit të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025

Kryetari – Theksoi se tani kemi për shqyrtim Strategjinë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025, ku Komisioni ka organizuar edhe dëgjimi publik në muajin e kaluar, dhe

ka marrë opinionet e gjitha palëve që kanë të bëjnë me këtë dokument, kërkojë të votohet për shkak të rëndësisë imediate që ka kjo Strategji për zhvillimin ekonomik të vendit. Për këtë pikë të rendit të ditës i pranishme është z. Gani Koci, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe ia kaloi fjalën për ta paraqitur përmbajtjen e Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025.

Gani Koci, zëvendësministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik) – Paraqiti para Komisionit objektivat që synohet të arrihet me këtë strategji, dhe rolin e saj për zhvillimin ekonomik. Ai njoftoi se kombinati "Trepça", sipas kësaj strategjie, do të funksionojë në bazë të Ligjit të veçantë. Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës 2012- 2025, ka dhjetë objektiva, për realizimin e të cilave janë paraparë të merren 63 masa implementuese, tha Koci.

Visar Ymeri - Tha se kjo strategji së pari duhet pasur planin konkret së çka dëshirohet të arrihet me të nga ana Qeverisë dhe si e tillë për mendimin tim nuk është Strategji, sepse nuk ka objektiva të qarta. Sa i përket çështjes se Trepçës nuk kemi ndonjë plan të qartë, pos që thuhet së për këtë ka ligje të veçanta. Është thënë së mund të ketë rreziqe nga kriza ekonomike globale, por kjo nuk qëndron, sepse nuk mund të paragjykohet së mund të ketë në vazhdimësi krizë ekonomike globale. Pastaj te taksa për rentën minerare dhe thëngjill janë të cekuar tri lloje të taksave, por nuk specifikohet së për çfarë lloje taksave bëhet fjalë dhe pyeti se a është e harmonizuar Strategjia me Listën për Rentën Minerare që e ka miratuar muajin e kaluar Kuvendi. Theksoj se në strategji duhet ceket së në cilën mënyrë të investimeve duhet të shkojmë, së çfarë lloje të taksave duhet të aplikojmë etj.

Hashim Deshishku - Tha se në këtë strategji në kapitullin për Trepçën thuhet së do të ketë rritje të numrit të punëtorëve, por nuk ceket së në bazë të cilave analiza pritet të ketë rritje të punëtorëve. Në kapitullin VII janë sfidat, por nuk janë paraqitur planet së si do të kalohen këto sfida. Për çështjen e hulumtimeve, theksoi së kemi analiza të hulumtimeve shumë të hershme duke filluar nga vitet e 70-ta, por nuk kemi do një hulumtim të ri për sasinë rezerva nëntokësore.

Myzejene Selmani - Tha se në bazë të ligjeve çdo Strategji mund të rishikohet dhe plotësohet çdo tri vjet, dhe propozoi që nëse ka diçka përmbajtësore dhe esenciale t'i shtohet si plotësime, dhe propozoi që Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025 të procedohet për miratim për seance plenare.

Sala Berisha – Shala - Kërkoi që sa më shpejt në bazë të proceduarave të miratohet Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025, sepse është dokument i nevojshëm për hapjen e rrugës së zhvillimit të minierave.

Gani Koci, zëvendësministër i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik) - Theksoi se për Trepçën e kemi të miratuar Ligjin për riorganizimin ndërmarrjeve shoqërore, dhe kjo çështje rregullohet ma anën e legjislacionit nga AKP-ja. Për çështjen e planit të Strategjisë, tha që kjo është e parapare pas aprovimit të Strategjisë të hartohet një plan i detajuar se do ta zhvillojmë sektorin e minierave. Për hulumtimet tha që është e vërtetë që nuk kemi hulumtime të reja, pos që jemi bazuar në ato të viteve 80, por presim shumë shpejt të behët licencimi i kompanive të profilizuara për hulumtime të resurseve nëntokësore.

Visar Ymeri -Tha së çështja e definimit të Strategjisë është e pa përcaktuar së çfarë objektiva do të arrihen në planin e investimeve për minierat. Për Trepçën nuk është dashur që të lihet vetëm më anën e një Ligji, si është për riorganizim ndërmarrjeve shoqërore, pa e plotësuar edhe më plan konkret në këtë strategji. Dhe kërkoj që Komisioni t'i nxjerrë disa rekomandime për plotësim dhe ndryshim të Strategjisë. Në fund z. Ymeri tha se do t'i propozojë ndryshimet në seancë plenare në emër të Grupit parlamentar.

Pas debatit Komisioni me 6 (gjashtë) vota Për, dhe 1(një) Kundër, nxori këtë

Përfundim

Miratohet Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025.

Dhe, Kuvendit i paraqet këtë

R e k o m a n d i m

Të miratohet Strategjia Minerare e Republikës së Kosovës për periudhën 2012 – 2025.

6. Të ndryshme

Çështjet vijuese.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit